

Raporti i vlerësimit të cilësisë për vitin akademik 2024/2025

Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm

1. Hyrje

Në këtë raport janë paraqitur vlerësimet e programit, mësimdhënësve dhe lëndëve nga studentët e programit Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm.

Vlerësimi i programit është realizuar përmes pyetësorit për vlerësim të programit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU), i cili përmban 21 komponentë. Ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga të gjithë studentët e këtij programi. Pyetjet e vlerësimit të programit janë kryesisht të përpiluara në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk pajtohem fare; 2 - Nuk pajtohem; 3 - Neutral; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

Vlerësimi i lëndëve dhe mësimdhënësve gjithashtu janë realizuar përmes pyetësorit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU). Për dallim nga vlerësimi i programit, i cili realizohet një herë brenda një viti akademik, vlerësimi i lëndës dhe mësimdhënësit realizohet në fund të çdo semestri. Edhe te ky vlerësim pyetjet janë të ndërtuara në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk pajtohem fare; 2 - Nuk pajtohem; 3 - Neutral; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

1.1 Raporti i vlerësimit të Programit nga studentët për vitin akademik 2024/2025

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të programit të paraqitura në tabelën nr. 1, vërejmë se pothuajse të gjitha komponentët e këtij sesioni janë vlerësuar me 4 e më lartë nga studentët. Duke iu referuar këtyre rezultateve, rëndësi e veçantë duhet t'iu kushtohet komponentëve të cilët kanë pësuar rënie në krahasim me vitet e mëparshme akademike. Në përgjithësi, kënaqshmëria e studentëve me programin këtë vit akademik është 80.3% apo 4.02.

Pohimi	Viti paraprak 2023/2022	Viti aktual 2024/2025
Materialet e prezentuara gjatë ligjëratave na jepen rregullisht	4.16	4.12
Literatura e sygjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	4.18	4.15
Syllabuset e lëndëve u ofrohen me kohë studentëve	4.22	4.18
Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	3.92	3.88
Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	3.90	3.86
Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse	4.22	4.18
Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	4.10	4.05
Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shumë nga ai në klasë	3.57	3.60
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve	4.08	4.02
Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për konkretizimin e mësimi	4.04	3.98
Ekziston një lidhje e mirë e mësimi teorik dhe atij praktik	3.78	3.72
Studentit është i lirë që vetë të përcaktohet për lëndët zgjedhore	4.12	4.08
Orari i mësimi shpallet me kohë	4.22	4.18
Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit	4.12	4.08
Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	4.16	4.12
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera	4.04	3.98
Angazhimi i studentit në lëndë është i balancuar (nuk është i mbingarkuar)	4.06	4.00
Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga Universiteti	3.88	3.84
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	4.04	4.00
Mendimi im i përgjithshëm për këtë program te studimit është pozitiv	4.20	4.16
Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve	4.20	4.14

Tabela 1. Vlerësimi i programit




Figura 1. Vlerësimi i cilësisë sipas fushave (programi dhe mësimdhënësit)

1.2 Raporti kumulativ i vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve për programin Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm për vitin akademik 2024/2025

Mësimdhënësit e programit Menaxhimi në Inovacion dhe Turizëm janë vlerësuar në çdo semestër nga studentët dhe në tabelën nr. 2 janë paraqitur rezultatet kumulative të këtij vlerësimi për secilin komponent. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të stafit akademik, vërejmë se të gjithë komponentët e këtij sesiioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, ose më saktësisht me mbi 4.00. Në përgjithësi, kënaqshmëria e studentëve me mësimdhënësit e tyre për vitin 2024/2025 është rreth 83.8% apo 4.19.

Pohimi	Viti paraprak 2023/2024	Viti aktual 2024/2025
Mësimdhënësi organizon dhe prezanton mirë materialin e lëndës	4.41	4.16
Mësimdhënësi përdor shembuj të mjaftueshëm praktik në klasë (raste studimore, punë praktike në laborator)	4.36	4.20
Mësimdhënësi i ka kushtuar kohë të mjaftueshme sqarimit të koncepteve komplekse	4.39	4.21
Mësimdhënësi jep udhëzime të qarta dhe të	4.37	4.23

mjaftueshme për të kuptuar ushtrimet dhe detyrat e lëndës		
Njohuritë dhe përvojat praktike të mësimdhënësit në industri kanë qenë të dobishme për mua	4.41	4.20
Gjatë orëve të ligjëratave mësimdhënësi u ka dhënë mundësi studentëve të bashkëveprojnë mes tyre	4.38	4.19
Mësimdhënësi ka nxitur pjesëmarrjen aktive dhe debatin mes studentëve	4.34	4.15
Mësimdhënësi ka qenë i çashtë për sqarime dhe ndihmë shtesë me lëndën	4.39	4.22
Mësimdhënësi më ka dhënë informata kthyesë të dobishme dhe konstruktive për detyrat/angazhimet tjera	4.40	4.21
Mësimdhënësi ka dhënë udhëzime të dobishme për zhvillimin tim në lëndën	4.37	4.16
Mësimdhënësi ka nxitur interesimin tim për lëndën dhe fushën në përgjithësi	4.34	4.17
Mësimdhënësi ka përdorur mirë teknologjinë gjatë procesit mësimor (teams, forms, programe softuerike etj...)	4.41	4.16

Tabela 2. Vlerësimi i mësimdhënësve

Në tablën nr. 3 janë shfaqur rezultatet e vlerësimit të lëndëve në programin Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm nga studentët e këtij programi. Të gjithë komponentët e këtij sesioni, përpos njërës, janë vlerësuar me mbi 4.00, dhe kënaqshmëria e studentëve me lëndët e programit për vitin akademik 2024/2025 është 83% apo 4.15.

Pohimi	Viti paraprak 2023/2024	Viti aktual 2024/2025
Lënda është e përshtatshme për programin e studimit	4.42	4.26
Qëllimi dhe objektivat e lëndës janë të sqaruar mire	4.43	4.24
Literaturat dhe materialet shtesë të lëndës (librat, shembujt praktik, burimet shtesë për lexim) ishin të përditësuara, të çashtë, dhe të përshtatshme	4.37	4.16
Lënda është realizuar në mënyrë efektive (bazuar në syllabusin e lëndës)	4.42	4.19
E kam pasur të qartë se çfarë pritet prej meje sa i përket angazhimeve të mia në këtë lëndë	4.43	4.23

Mjetet dhe materialet e përdorura gjatë mësimit më kanë ndihmuar të kuptoj lëndën më mirë	4.36	4.20
Aktivitetet në klasë më kanë ndihmuar të kuptoj lëndën më mirë	4.32	4.09
Lënda ka pasur një balancë të mirë të ligjëratave teorike dhe mësimit praktikës (ushtrimeve numerike, rasteve të studimit, vizita studimore etj..)	4.29	4.13
Kam pasur informata të detajuara për mënyrën e vlerësimit	4.36	4.21
Puna në grupe më ka ndihmuar të zhvilloj shkathtësitë e bashkëpunimit	4.30	4.07
Mësimi praktik (puna në laborator, puna në terren, përdorimi i shembujve praktik etj....) më ka ndihmuar të zhvilloj kompetencat profesionale	4.26	3.87

Tabela 3. Vlerësimi i lëndëve

Pas shqyrtimit të të dhënave të nxjerra nga Sistemi i Menaxhimit Universitar, të cilat tregojnë një rënie të kënaqësisë së studentëve me programin e tyre studimor, rekomandohet që të ndërmerren hapa të menjëhershëm nga menaxhmenti i programit për përmirësimin e cilësisë së programit. Kjo mund të bëhet përmes disa mënyrave, si organizimi i sondazheve dhe diskutimeve me studentët për të kuptuar më mirë shkaqet e kësaj rënieje. Gjithashtu, mund të shqyrtohen dhe përmirësohen metodat mësimore, burimet e përdorura, dhe mbështetja e ofruar nga stafi akademik. Për më tepër, sigurimi i mundësive për zhvillimin e aftësive praktike mund të ndikoj pozitivisht në përvojën e studentëve.